



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ prot.

Lezhe, më _____.____.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDERTIMI I INFRASTRUKTURES RRUGORE NE PLAZHIN E TALES, NJESIA ADMINISTRATIVE SHENKOLL”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: **76,897,654.66** (shtatedhjetë e gjashtë milion e teteqind e nentedhjetë e shtate mije e gjashtëqind e pesedhjetë e kater pike gjashtedhjet e gjashtë) Lek pa TVSH,

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kerkohet nje operator ekonomik i cili te kete minimumin e kerkuar duke marre ne konsiderate objektin e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar ne ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e maturuara te taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, për vitin 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet

te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratën;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi;
5. Faturat tatimore;

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrije;
2. Leje per kryetje punimesh;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatë të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1 A Punime gërmimi në tokë.

NP-4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

NP-11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

NP-12 C Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese.

NS-18 C Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i

punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane."

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore qe do te beje Kontraktori per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates ne kete objekt jane:

- Mobilizimi
- Investigimi topografia dhe piketimi i nen objekteve
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve te Tokes
- Aktivitetet e Punimeve te Betonit
- Aktivitetet e Punimeve te Asfaltimit
- Aktivitetet e Punimeve Hidroteknike te Rrjetit te Kanalizimeve
- Aktivitetet e Punimeve ndertimore
- Aktivitetet per punime elektrike
- Aktivitetet per punime te sinjalistikes rrugore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe janë analizuar ne tabelen e meposhteme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A “Punime germimi në toke”	Ne preventiv parashikohen punime per: Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , me shk ne mjet per murin mbajtes, Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , me shk ne mjet per trupin e rruges + trotualet Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale	1,496,056.22 leke

	gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	
NP-4 B “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale”	Projekti parashikon punime mbushje ne Rruge, Punime Shtresa rrugore, Punime ne sinjalistiken rrugore, Punime shtresash per trotuarin e rruges etj. Ne lidhje me kategorine “B” duke qene se vlera e preventivit per kete objekt prokurimi eshte mbi kufirin minimal per kete katrgori license qe perfshin vlerat nga 21-50 milion leke.	26,583,568.09 leke
NP-11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Preventivi parashikon punime te ndricimit rrugor, te trotuarit dhe te rruges se re.	5,126,361.31 leke
NP-12 C Punime të inxhinierisë mjedisore	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Duke qene se cdo proces i punes i perfshire ne zerat e preventivit ka ndikim ne mjedis pasi punimet per ndertimin e rruges dhe trotuarit kerkojne nje mbrojtje te mjedisit. Gjithashtu referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te pergjithshme ne kujdesin per mjedisin.	74,657,917.14 leke
NS-6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese.	Preventivi parashikon Punime sinjalistike rrugore si me poshte: Vijezi me shirita gjatesor dhe anesor gjeresia 12 cm me boje bikomponente, Vijezi me boje bikomponente (per kembesore etj), F.V kurriz artificiale h= 5cm,	331,566.40 leke
NS-18 C Punime topogjeodezike.	Referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike konsiderohen punime topogjeodezike, duke qene se i gjithe projekti dhe ne zerat e preventivit jane parashikuar punime te natyres topogjeodezike (gjurma projektit, plani i rivelimit, planimetria e objekteve dhe elementet perberese te saj tj.) dhe duke qene se keto punime nuk jane te ndara ne zera konkret preventivi por eshte gjithpefshire si rrjedhoje eshte e nevojshme zoterimi i kesaj pike	74,657,917.14 leke

	license me kete kategori me qëllim realizim me sukses të ketij projekti.	
--	--	--

I. Ne lidhje me kërkesën për disponueshmëri të kategorisë së pikës NP-12, të licencës dhe nivelit të klasifikimit "C", Njësia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrime të përgjithshme në kujdesin për mjedisin.

N.P. 12 "Punime të inxhinierisë mjedisore", ***Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor***, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Sa i përket klases "C" të kërkuar, theksojmë se kjo fushë specifike nuk shprehet në zera konkret të preventivit, por është komplekse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, nga momenti i marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe dorëzimin pranë AK-se, të sheshit të ndërtimit.

Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrime të përgjithshme në kujdesin për mjedisin e për rrjedhojë kjo kërkesë është në proporcion me natyrën, volumin dhe kompleksitetin e kontratës.

Vecanerisht në specifikimet teknike të hartuar nga projektuesi kërkohet që *“Sipërmarresi, me shpenzimet e veta, duhet të ndermarret të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mosplotesimi i kësaj klauzole, në bazë të evidentimit nga Mbiqyrtari i Punimeve, mund të çojë në ndërprerjen e kontratës”*.

Po ashtu në raportin teknik të hartuar nga projektuesi kërkohet që *“Minimizimi në maksimum i zhurmave dhe i ndotjes në të gjitha zonat urbane ekzistuese në zonën e projektit. Të minimizojë ndërhyrjet që behen në terren jashtë atyre të parashikuara në projekt”*.

II. Në lidhje me kërkesën për disponueshmëri të kategorisë së pikës NS-18, të licencës dhe nivelit të klasifikimit, Njësia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, i gjithë piketimi do të kryhet nga Sipërmarresi.

Theksojmë se kërkesa për këtë kategori dhe klase license është bërë dhe në përputhje me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008, *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, ku përcaktohet se:

N.S - 18 "Punime topogjeodezike", konsiderohet *zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sa i perket klases "C" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithepershires ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumin dhe kompleksitetin e kontrates dhe kategoritë dhe klasat e licencës janë ne proporcion me vlerën e fondit limit, raporteve teknike, specifikimet teknike dhe zërave te preventivit objekt i kësaj kontrate si dhe konform përcaktimeve referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008

Po ashtu ne specifikimet teknike te hartuar nga projektuesi kerkohet qe “*Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave siç kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit, dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. I gjithe procesi duhet te jete nen mbikqyrjen e plote te supervizorit.*

Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene, dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij nese nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt.

Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive. Sipermarresi do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar siç mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipermarresi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.

Perpara çdo aktiviteti ndertimor, Sipermarresi do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve.

Çdo pune e bere jashte akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shites gjithmone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve”.

2.3.3 Operatoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 30 (dhjete) personave të siguruar për periudhen Korrik 2022 - Shtator 2022.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit të mesiperm për numerin minimal të punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojë në Licensën e kompanisë si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi (profili transport)	1 (nje) Diplome Universitare
Inxhinier Elektrik	1 (nje) Diplome Universitare
Inxhinier Hidroteknik	1 (nje) Diplome Universitare
Inxhinier Mjedisi	1 (nje) Diplome Universitare
Inxhinier Gjeodet/ Topograf	1 (nje) Diplome Universitare

-Për stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listepagesat e kompanisë së minimalisht për periudhën Korrik 2022 - Shtator 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur bazuar ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyren e puneve te objektit te prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, te cilet jane te nevojshem per realizimin e punimeve. Per me teper duke qene se keto punime jane te nje rendesie te vecante dhe ne te njejten kohe konsistojne ne nderhyrje mjedisore shikohet e nevojshme qe te kerkohen specialist te fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Elektrik, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mjedisi dhe Inxhinier Gjeodet/Topograf.

Ne lidhje me kerkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Ndertimi profile transport, njesia prokurimit ka marre ne konsiderate se projekti per ndertimin e infrastruktures ndertimi i Infrastruktures Rrugore ne Plazhin e Tales, Njesia Administrative Shenkoll, ka si qellim kryesor qe te siguroje segment rrugore sipas standarteve ne fushen e transportit rrugor dhe trotuar per kembesoret dhe eshte detyrimisht e nevojshme disponimi i nje inxhinieri ndertimi profili transport.

Ne lidhje me kerkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Elektrik, Njesia ka marre ne konsiderate se projekti dhe preventi i punimeve parashikon punime te ndricimit rrugor te trotuarit dhe te rruges se re. Sa me siper eshte e nevojshme prania e nje drejtuesi teknik me njohuri ne fushen elektrike me qellim realizimin me sukses te kontrates.

Ne lidhje me kerkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Hidroteknik, Njesia ka marre ne konsiderate se projekti dhe preventi i punimeve parashikon punime te ndertimit te sistemit te kanalizimeve te ujerave te bardha te trotuarit dhe te rruges se re dhe me qellim realizimin ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates kerkohet disponimi i nje inxhinieri hidroteknik.

Ne lidhje me me kerkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Mjedis, Njesia ka marre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te pergjithshme ne kujdesin per mjedisin. Metodatat e punes qe duhet te aplikohen nga zbatuesi duhet te synojne ne minimizimin ose nese eshte e mundur ne ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kerkohet qe te ndermerren me regorozitet masa mbrojtese sa here qe te jete e nevojshme per te minimizuar ose per te ndaluar efektin negativ ne mjedis.

Po ashtu ne raportin teknik te hartuar nga projektuesi kerkohet qe *“Minimizimi ne maksimum i zhurmave dhe i ndotjes ne te gjitha zonat urbane ekzistuese ne zonen e projektit. Te minimizojte nderhyrjet qe behen ne terren jashte atyre te parashikuara ne projekt”*.

Ne lidhje me me kerkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Gjeodet/Topograf, Njesia ka merre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, i gjithë piktetimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Po ashtu ne specifikimet teknike te hartuar nga projektuesi kerkohet qe *“Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piktetave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit, dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. I gjithë procesi duhet te jete nen mbikqyrjen e plote te supervizorit*.

Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene, dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij nese nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt.

Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive. Sipermarresi do te furnizojte dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistencen nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piktetave.

Sipermarresi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piktetave.

Bazuar ne preventivin e punimeve parashikohen te realizohen punime te natyres ndertimore, elektrike, hidroteknike qe njekohesisht kerkojne edhe njohuri te fushes topografike si dhe ne mbrojtjen e mjedisit si dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithë etapat e punes qe kerkohet te realizohet, kerkon minimalisht inxhinieret e kerkuar.

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Inxhinier Ndertimit	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	3 (tre)	Leje Drejtimi
- Manovrator	3 (tre)	Çertifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmite profesionale/ Leje Drejtimi/ Çertifikate e Aftesise Profesionale (CAP), sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Korrik 2022 - Shtator 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbështetës, Inxhinier ndertimi, Teknik ndertimi, Teknik Elektrik, Kapertier, Hekurthyes, Shofer dhe Manovrator, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome Universitare, Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi etj, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar në kuptim të nenit 4, pika 17, të ligjit Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Po ashtu profilet e kërkuar dhe numr i tyre, janë kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit te tyre dhe mjeteve qe duhet te jene ne dispozicion.

Ne vijim referuar natyrës se punimeve si edhe listës se makinerive të cilat janë te nevojshme për kryerjen e punimeve, Nj.P konstaton se kryesisht përbëhen nga makineri ndërtimi, ndaj edhe kërkesa per Manovratorët dhe Shofer është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit. Gjithashtu kontraktori duhet te marre te gjitha masat e duhura paraprake per mbrojtjen e punetoreve, publikut si dhe pasurive dhe përreth sheshit te ndertimit konform ligjeve ne fuqi. Ai eshte pergjegjes i vetem per respektimin e masave te sigurimit teknik, kodeve te ndertesave dhe ndertimeve te tjera.

Theksojme se kriteret e mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës në respekt të nenit 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të nenit 39, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të pikës 1, të Vendimit nr. 808, datë 04.12.2003 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, i ndryshuar.

Po ashtu profilet e kërkuar dhe numri i tyre, janë kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit të tyre dhe mjeteve që duhet të jenë në dispozicion, pasi parashikohen punime për ndërtimin e infrastruktures ndërtimi i Infrastruktures Rrugore në Plazhin e Tales, Njesia Administrative Shenkoll e cila përfshin punime germimi, mbushje në rrugë, punime shtresa rrugore, punime në sinjalistikën rrugore, punime shtresash për trotuarin e rruges, punimet për ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të bardha, punime të ndricimit rrugor të trotuarit dhe të rruges së re,

Sa me sipër me qëllim realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukses të kontratës si dhe kontrolli i nevojshëm në të gjithë etapat e punës që kërkohet të realizohet, kërkon minimalisht stafin e kërkuar.

2.3.6 Operatoret Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

2.3.6/a -1 (nje) punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë punë, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Korrik 2022 - Shtator 2022.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi

për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Sa me sipër, nevojitet angazhimi i punonjesve të certifikuar dhe me njohuri të posacme sipas kërkesave të mesiperme.

2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 5 deri ne 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
4	Eskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
5	Fadrome	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
6	Rrul Hekur-Hekur	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
7	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
8	Asfaltoshtuese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
9	Autobetoniere	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
10	Betoniere kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e mëposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit të mesiperme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesiperme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence e leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojnë një kujdes maksimal në transportin e mbetjeve inerte me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si më poshtë vijon:

- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
- b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni
- c. 1 (nje) Impiant prodhimi Asfalti

Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit/ asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe

dokumentacion qe verteton pronesine. Ne rast se impianti i prodhimit te inerteve/ betonit/ asfaltit eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerases/ bashkepunimit.

(KVO do te verifikojë nepermjet QKB nese impianti i prodhimit te inerteve/ betonit/ asfaltit eshte i pajisur me license III.1.B, ne rast te kundert OE do te skualifikohet).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar ne zerat e preventivit si dhe punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te ketyre materialeve duke qene se perbejne pjesen me te konsiderueshme te preventivit te punimeve.

Autoriteti Kontraktues referuar zerave objekt i kontrates qe po prokurohet ka kerkuar qe impiantet e prodhimit te cilat mund te jene ne pronesi, me qera ose marreveshje bashkepunimi te operatorit ekonomik qe do te shpallet fitues si nje garanci teknike qe kontrata do te realizohet brenda afateve dhe ne te gjithë kompleksitetin e zerave te punimeve

2.3.10 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

Per Materialet Elektrike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Per Materialet Tub brinjezuar HDPE:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit, duke marre ne konsiderate se rendesine e zones ku do te kryhen punimet shfaqet e nevojshme qe per mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor te garantohet qe keto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet te kete nje kontrate bashkepunimi me nje laborator te testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetare ose nderkombetare, sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008; SSH EN 12350-2: 2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rëndësise se vecante të objektit të prokurimit, duke marrë në konsideratë se rëndësine e zonës ku do të kryhen punimet shfaqet e nevojshme që për betonin që do të perdoren në realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor të garantohet që këto mall furnizohet nga prodhuesi brenda standarteve teknike.

2.3.12 Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2018**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.
- **ISO 39001:2012**, mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” ose ekuivalentin e saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, në të cilën argumentohet se janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia përgjegjëse përkatëse në hartimin e specifikimeve teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: